



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 6 të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022 duke u bazuar edhe në Kërkesën e Drejtoratit Komunal për Arsim 1Nr.400/01-42081 të datës 08.08.2022, Kryetari i Komunes nxjerr:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË BURSIVE DHE SHUMËS FINANCIARE PËR NJË BURSË PËR STUDENTË PËR VITIN AKADEMIK-SHKOLLOR 2022/2023

Neni 1

I Me këtë Vendim CAKTOHET që për vitin akademik 2022/2023 të ndahen 160 (njëqind e gjashtë dhjetë) bursa dhe shuma finaciare për një bursë do të jetë 500 € (pesëqind) euro.

Neni 2

OBLIGOHET, Drejtorati për Arsim që menjëherë pas pranimi të këtij Vendimi të përgadisë Thirrjen publike për aplikim, konform kriterëve të përcaktuara me dispozitat e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022 dhe të njëjtën ta publikojë në faqen zyrtare të Komunës , në njërën nga gazetatat ditore me tirazh të madh dhe në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

Neni 3

Shuma e cekur nga neni 1 i këtij Vendimi do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit, kategoria e subvencioneve në xhirollogaritë personale të secilit përfitues të zgjedhur.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Drejtorati për Arsim.

1Nr. 400/01-42081
Lipjan, më 09.08.2022

KRYETARI I KOMUNËS
për Imri Ahmeti

